

AKT - THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"GREEN ENERGY GENERATION" sh.p.k
(ORTAKET)

FORMIMI

Bazuar në kërkesat e ligjit nr 9901 datë 14.04.2008 "Për shoqëritë tregtare" formohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar **"GREEN ENERGY GENERATION" sh.p.k** e ortakeve themelues:

z.Rafael Lala, shtetas Shqiptar, i biri i Ndue, e datëlindjes 20.09.1978, lindur Vau dejes,Shkoder dhe banues në Tiranë, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, e identifikuar me dokument identifikimi nr **H80920206S**.

Sot me datë 21.06.2022, kam vendosur të themeloj në Lezhe, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin **"GREEN ENERGY GENERATION" sh.p.k**.

SELIA

Selia e shoqërise ndodhet në adresen : Lezhe, Shengjin, Ishull Shengjin, Lagjia "Fran Ivanaj", Rruga Kune, Apartament ne zonen kadastrale 1987, nr pasurie 3/703+1-8, kati 2.

Shoqëria ka të drejtë të hapë zyra, përfaqësi dhe filiale edhe në rrethet e tjera të vendit si dhe jashtë shtetit.

FORMA JURIDIKE

Forma juridike e shoqërisë është "Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar".

Kohëzgjatja e veprimtarisë ekonomike të shoqërisë është e pakufizuar në kohë.

OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Objekti i veprimtarisë ekonomike të shoqërisë **"GREEN ENERGY GENERATION" sh.p.k**, është :

- Aktivitet në fushen e energjise se rinovueshme, fotovoltaike, prodhim dhe shitje energjie.
- Çdo aktivitet tjetër që është i lejuar nga ligji.

KAPITALI I SHOQERISË

Kapitali i shoqërisë është **1 000 000** (nje milion) lekë. Të ndara në 1 kuote, të cilat përbëjnë 100% të kapitalit.

z.Rafael Lala, 1 kuotë ose 100% të kapitalit.

ORGANET DREJTUESE

Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimarrës i shoqërisë. Ortakët kanë të drejtë të marrin pjesë në asamble dhe të bëjnë prezent opinionin e tyre. Numri i votave të çdo ortaku është në raport me pjesën e tij të kapitalit në kapitalin themelor të shoqërisë.

Shoqëria "**GREEN ENERGY GENERATION**" sh.p.k, do të drejtohet nga administratori z.Rafael Lala, që emërohet nga ortakët themelues të kësaj shoqërie me afat 5-së vjeçar me të drejtë përsëritje. Në marrëdhënie me të tretët shoqëria përfaqësohet nga administratori.

Në emër të shoqërisë firmos administratori i cili i bashkëngjitet emrin tregtar të shoqërisë, emrin, mbiemrin dhe funksionin e tij.

Akti i Themelimit nënshkruhet rregullisht nga ortakët themelues.

Ky akt themelimi hartohet konform ligjit në fuqi në katër kopje për tu dorëzuar në organet kompetente.

THEMELUESIT E SHOQERISE

Rafael LALA

